


# EPIK BRIEF

PRILL 2019

PROGRAMI KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E MSA-SË  
(PKZMSA)



# PROGRAMI KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E MSA-SË (PKZMSA)



Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) hyri në fuqi më 1 prill 2016. Në këtë kuadër, Kosova ka marrë për detyrim që të zbatojë dispozitat e MSA-së brenda periudhës dhjetëvjeçare. Me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së, Kosova miraton çdo vjet Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) është dokument kyç i institucioneve të Republikës së Kosovës i cili ka për synim zbatimin e detyrimeve të Kosovës që burojnë nga MSA. Kërkesa për hartimin e Programit buron nga neni 74, pika 3 e MSA-së. Dokument të tillë, me emërtime të ndryshme, e kanë në fuqi të gjitha vendet e rajonit që janë pjesë e procesit të Stabilizim Asociimit, psh. në Shqipëri: Plani Kombëtar për Integrim Evropian, në Serbi: Programi Kombëtar për Adoptimin e Acquis apo në Mal të Zi: Programi Kombëtar për Anëtarësim në BE.

MSA ka vulosur orientimin strategjik të Kosovës për t'u anëtarësuar në BE dhe ka krijuar kornizën formale dhe kontraktuale për të arritur këtë qëllim.

MSA në 600 faqe, X tituj, 7 shtojca dhe 5 protokolle, rregullon pothuajse çdo aspekt të jetës së përditshme të qytetarëve.

# VITI 2018:

Nga 532 masa te planifikuara  
- vetëm 362 të zbatuara



Përgatitja e Programit koordinohet nga Ministria e Integritimit Evropian. Ky program përmban masa konkrete të cilat propozohen nga vet institucionet e shtetit për të adresuar dispozitat e veçanta të MSA-së.

Në këtë kontekst, në baza vjetore ka pasur regres të vazhdueshëm në numrin e reformave të parapara, dhe të zbatuara.

Në bazë të statistikave të vetë institucioneve:

- Në vitin 2016, programi kishte 1,347 masa, nga të cilat institucionet arritën të përmbushin 741.
- Në vitin 2017, programi kishte 967 masa, nga të cilat institucionet arritën të përmbushin 600.
- Në vitin 2018, programi kishte 532 masa, nga të cilat institucionet arritën të përmbushin 362.


Krahasuar me vitin 2016, në vitin 2018 kemi numër më të vogël të masave të parapara dhe të zbatuara në kuadër të implementimit të dispozitave të MSA-së.

Në vitin 2016, janë zbatuar 741 masa nga 1,347 sa ishin gjithsej, ndërsa në vitin 2018, numri masave të zbatuara ka rënë në 362 nga 532 masa te planifikuara - që i bie se nuk është arritur të përmbushet 1/3 e planifikimit vjetor për vitin 2018.

# 1/3 E DETYRIMEVE TË MSA-SË NUK ZBATOHET



# NUMRI I MASAVE TË ZBATUARA (2016-2018)



INSTITUTI I KOSOVËS PËR POLITIKAT EVROPIANE, 2019.  
TE GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA.

